



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 153

12 shtator

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8301 datë 6.9.2013	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 6999
Vendim i KM nr. 745, datë 5.9.2013	Për krijimin e Qendrës Shumëfunksionale të Arsimit dhe Formimit Profesional në Kamëz, dhe funksionimin e saj gjatë periudhës kalimtare 2013 – 2018 6999
Vendim i KM nr. 746, datë 5.9.2013	Për një ndryshim në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar..... 7001
Vendim i KM nr. 747, datë 5.9.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 638, datë 31.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09 “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë” 7002
Vendim i KM nr. 748, datë 5.9.2013	Për lejin e kryerjes së procedurave të prokurimit publik dhe zhbllokimin e fondeve për investime të vitit 2013, për Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe prokurorinë e rrethit gjyqësor Pogradec, si autoritete kontraktore 7002
Vendim i KM nr. 749, datë 5.9.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Karinë të qarkut të Elbasanit 7003
Vendim i KM nr. 750, datë 5.9.2013	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit Bujqësor të Tiranës..... 7004

Vendim i KM nr. 751, datë 5.9.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 81, datë 30.1.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit”.....	7004
Vendim i KM nr. 753, datë 5.9.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Arsti”.....	7007
Vendim i KM nr. 754, datë 5.9.2013	Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gjergjovinë”.....	7007
Vendim i KM nr. 755, datë 5.9.2013	Për lejimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, si autoritet kontraktor, të publikojë njoftimin e kontratës së nënshkruar për disa objekte të prokurimit publik.....	7008
Vendim i KM nr. 756, datë 5.9.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim K/rruga nacionale Laç - Patok (vazhdimi)”.....	7009
Vendim i KM nr. 773, datë 5.9.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	7011
Vendim i KM nr. 775, datë 5.9.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Kamëz të qarkut të Tiranës	7011
Vendim i KM nr. 781, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7012
Vendim i KM nr. 782, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7013
Vendim i KM nr. 783, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7013
Vendim i KM nr. 784, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7013
Vendim i KM nr. 785, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7014
Vendim i KM nr. 786, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7014
Vendim i KM nr. 787, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7014

Vendim i KM nr. 788, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7015
Vendim i KM nr. 789, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7015
Vendim i KM nr. 790, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7015
Vendim i KM nr. 791, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7016
Vendim i KM nr. 792, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7016
Vendim i KM nr. 793, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7016
Vendim i KM nr. 794, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7017
Vendim i KM nr. 795, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7017
Vendim i KM nr. 796, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7017
Vendim i KM nr. 797, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7018
Vendim i KM nr. 798, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7018
Vendim i KM nr. 799, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7018
Vendim i KM nr. 800, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7019
Vendim i KM nr. 801, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7019
Vendim i KM nr. 802, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7019
Vendim i KM nr. 803, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7020
Vendim i KM nr. 804, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7020

Vendim i KM nr. 805, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7020
Vendim i KM nr. 806, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7021
Vendim i KM nr. 807, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7021
Vendim i KM nr. 808, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7021
Vendim i KM nr. 809, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7022
Vendim i KM nr. 810, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7022
Vendim i KM nr. 811, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7022
Vendim i KM nr. 812, datë 5.9.2013	Për lirim nga detyra.....	7023
Vendim i KM nr. 813, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Maxhun Peka	7023
Vendim i KM nr. 814, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Flamur Shehu	7023
Vendim i KM nr. 815, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Tonin Tershana.....	7024
Vendim i KM nr. 816, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Justina Aliaj	7024
Vendim i KM nr. 818, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Pranvera Bekteshi.....	7025
Vendim i KM nr. 819, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Saimir Maloku.....	7025
Vendim i KM nr. 820, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Pali Kuke....	7025
Vendim i KM nr. 821, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Ndoc Tusha..	7026
Vendim i KM nr. 822, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Luan Myftiu..	7026
Vendim i KM nr. 823, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Adem Allçi..	7027

Vendim i KM nr. 824, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Filip Meshi..	7027
Vendim i KM nr. 825, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Reshat Kripa	7027
Vendim i KM nr. 826, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Nikolla Profkola.....	7028
Vendim i KM nr. 827, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Flamur Tartari	7028
Udhëzim i MASH nr. 43, datë 21.8.2013	Për planifikimin e fondve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike	7029
Vendim i ERE nr. 83, datë 26.8.2013	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2013 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.....	7030

DEKRET
Nr. 8301, datë 6.9.2013

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15, 16 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Fatmir Agron Qelibari | 10. Ylber Mehdi Ismailaj |
| 2. Eriona Fatmir Zeneli | 11. Ilir Skender Dikollari |
| 3. Argita Bardhyl Lleshi | 12. Loana Arjan Juka |
| 4. Almir Lefter Kashta | 13. Teuta Qirjako Kirchner (Hodo) |
| 5. Mimoza Fejzi Zogaj (Shaha) | 14. Daniela Diogjen Bardhi |
| 6. Marinela Gëzim Merko (Kepi) | 15. Vladimir Shtjefën Fizi |
| 7. Vjosela Denis Merko | 16. Edias Lavdërim Isak |
| 8. Ajla Denis Merko | 17. Fatjon Edmond Celani |
| 9. Teuta Bilal Shametaj (Harizaj) | 18. Kastriot Aqif Kenga |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 745, datë 5.9.2013

**PËR KRIJIMIN E QENDRËS SHUMËFUNKSIONALE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL NË KAMËZ, DHE FUNKSIONIMIN E SAJ GJATË
PERIUDHËS KALIMTARE 2013 – 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “b” të nenit 7 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës Shumëfunksionale të Arsimit dhe Formimit Profesional (QSHAFP) në Kamëz, mbi bazën e Shkollës së Mesme Profesionale Kamëz, si një institucion publik për arsimin



dhe formimin profesional (AFP), që gëzon statusin e personit juridik, të veçantë për drejtimet e veprimtarisë, që përcaktohen në këtë vendim.

2. Misioni i QSHAFF-së Kamëz është të sigurojë:

a) arsim dhe formim profesional për nivelet I – III të AFP-së;

b) arsim profesional të avancuar pas arsimit të mesëm me frekuentim të plotë në shkollë ose të integruar me praktikë në vendet e punës në kompani (forma duale e AFP-së);

c) kurse formimi për të rritur sipas nevojave të tregut të punës.

3. QSHAFF-ja Kamëz ka këto funksione kryesore:

a) Të sigurojë arsim dhe formim profesional të mesëm dhe pas të mesëm me frekuentim shkollor të plotë dhe të pjesshëm ose të formës duale, arsim dhe formim profesional të integruar me praktikën në shoqëritë tregtare;

b) Të mbështesë të diplomuarit pas përfundimit të studimeve, që të hyjnë në tregun e punës, duke bashkëpunuar me Shërbimin Kombëtar të Punës (SHKP), partnerët socialë dhe shoqëritë tregtare;

c) Të nënshkruajë marrëveshje me shkolla të arsimit dhe formimit profesional dhe me qendra homologe që funksionojnë jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për shkëmbimin e dijeve të nxënësve, duke informuar Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;

ç) Të bashkëpunojë me sipërmarrjet ekonomike, organizmat socialë dhe shoqëritë tregtare partnere (si për sistemin me frekuentim të plotë dhe të pjesshëm, ashtu edhe për atë dual);

d) Të sigurojë certifikata dhe diploma për të rinj e të rritur në fushat përkatëse të arsimit dhe formimit profesional, pas përfundimit me sukses të programeve të ndryshme të AFP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. QSHAFF-ja kalon një periudhë kalimtare, që zgjat 5 vjet (2013-2018), gjatë së cilës organizohet në departamente të arsimit dhe formimit profesional, të cilat janë njësi bazë të mësimdhënies. Propozimi për hapjen ose mbylljen e një departamenti bëhet nga bordi i drejtimit, me miratimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

5. QSHAFF-ja, gjatë periudhës kalimtare, e mbështet veprimtarinë në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, në statut dhe në këtë vendim.

6. Statuti i QSHAFF-së, për periudhën kalimtare, miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Gjatë fazës kalimtare, bordi i QSHAFF-së quhet bordi i drejtimit. Detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me udhëzimin përkatës të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i përshtatur gjatë fazës kalimtare, sipas kërkesave të veçanta të QSHAFF-së.

8. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bordit të drejtimit dhe sekretariatit të tij përcaktohet me rregulloren e brendshme të QSHAFF-së, të hartuar nga anëtarët e bordit dhe të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Mandati i anëtarëve të bordit të drejtimit është i kufizuar deri në përfundim të fazës kalimtare.

9. Marrëdhëniet e punës së personelit mësimdhënës të QSHAFF-së rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. QSHAFF-ja Kamëz financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme, brenda fushave të veprimtarisë së saj.

11. QSHAFF-ja Kamëz vepron si njësi ekonomike me llogari më vete, sipas legjislacionit në fuqi. Ajo kryen veprimtari ekonomike jo për qëllime përfitimi, por vetëm me synim realizimin e shërbimeve arsimore dhe të formimit profesional sipas legjislacionit në fuqi.

12. QSHAFF-ja Kamëz ka të drejtë të krijojë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur 100% të ardhurave financiare që rezultojnë nga aktivitete kryesore dhe dytësore, si edhe nga bashkëpunimi me palët e treta vendase apo të huaja, bazuar në legjislacionin në fuqi. Ajo mund të krijojë të ardhura financiare në mënyrë të pavarur, përmes tarifave të shërbimeve për kurset afatshkurtra të programeve të ndryshme të AFP-së, kur ka kërkesë nga palët e treta, bazuar në legjislacionin në fuqi. Tarifat për shërbimet që do të ofrojë QSHAFF-ja Kamëz, miratohen me udhëzim/urdhër të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

13. Të gjitha aspektet e funksionimit të QSHAFF-së Kamëz, gjatë periudhës kalimtare, të cilat nuk janë parashikuar në këtë vendim, rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi dhe statutit të kësaj qendre.

14. Struktura dhe organika e QSHAFF-së miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, brenda numrit të punonjësve të miratuar për Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz.

15. QSHAFF-ja ushtron veprimtarinë në mjediset e Shkollës së Mesme Profesionale Kamëz dhe, për të plotësuar standardet e nevojshme për mësimdhënie, përdor bazën materiale, didaktike dhe laboratorët e kësaj shkolle.

16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të parashikuara për mbulimin e pagave, sigurimet shoqërore, shpenzimet për blerje materiale e shërbimesh, si dhe fondet për investime, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

17. Në fund të periudhës kalimtare, Ministri i Arsimit dhe Shkencës propozon akte të mëtejshme nënligjore për funksionimin e mëtejshëm të QSHAFF-së.

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 746, datë 5.9.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR
DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 7926, datë 10.5.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e objekteve për të cilat kalohet e drejta e përfaqësuesit të pronarit për pronën shtetërore tek organet e qeverisjes vendore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet nga Ndërmarrja e Uzinës Mekanike Bujqësore Korçë asemi “Reparti i kombinuar”, privatizuar nga ish-shoqëria Vefa Holding sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 747, datë 5.9.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 638, DATË 31.7.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR.
46684/07 DHE NR. 34770/09 “MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR
SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 638, datë 31.7.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 748, datë 5.9.2013

PËR LEJIMIN E KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK DHE
ZHBLLOKIMIN E FONDEVE PËR INVESTIME TË VITIT 2013, PËR PROKURORINË E
PËRGJITHSHME, PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR DHE
PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC, SI AUTORITETE
KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e zhbllokimit të fondeve për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, të cilat i përkasin fondit të investimeve të parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2013, e të përfshirë në aneksin nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 749, datë 5.9.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KARINË TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Karinë të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 139 (njëqind e tridhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1553 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Karinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Karinë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9, 10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të shëndetit publik	Në pronësi
11-27, 403-405	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
247-256, 388-394	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (troje)	Në përdorim
30-31	Prona që përdoren për realizimin e programeve të zhvillimit ekonomik	Në pronësi
327-337	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Nuk transferohen sipërfaqe të tokës bujqësore të trajtuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868, datë 18.6.2008



332/1, 366/1, 337/1, 344, 1461-1553	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
32-244, 395-398	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
245-246	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (sheshe)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 750, datë 5.9.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Lista, që i bashkëlidhet këtij vendimi përbëhet nga 28 (njëzet e tetë) fletë.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 751, datë 5.9.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 81, DATË 30.1.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË KOMUNËS BRADASHESH TË QARKUT TË ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit, të pasurive numër 551/1 dhe numër 551/2, me sipërfaqe 29 928 (njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) m², ndodhur në zonën kadastrale 2124, Bradashesh, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u përdorur për ndërtimin e shkollës së mesme, kopshtit, çerdhes dhe ambienteve sportive.


2. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i shtohen listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit.


3. Komunës Bradashesh i ndalohe t'i ndryshojë destinacionin pronës përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, komuna Bradashesh e qarkut të Elbasanit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha





VENDIM
Nr. 753, datë 5.9.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“ARSTI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Arsti”, që i jepet shoqërisë “Shpresa AL” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Arsti”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 754, datë 5.9.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“GJERGJOVINË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Gjergjovinë”, që i jepet shoqërisë “Construction Management Alliance Albania” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Gjergjovinë”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 755, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR, SI AUTORITET KONTRAKTOR,
TË PUBLIKOJË NJOFTIMIN E KONTRATËS SË NËNSHKRUAR PËR DISA OBJEKTE
TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, si autoritet kontraktor, të publikojë njoftimin e kontratës së nënshkruar për disa procedura të prokurimit publik, si më poshtë:

- Ndërtimi i rrugëve paralele superstrada Tiranë – Vorë, krahu i majtë, vazhdimi (shtesë kontrate);
- Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, segmenti F. F-Unaza Tiranë (shtesë punimesh);
- Ndërtim, Rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan (shtesë punimesh));
- Sistemim-asfaltim, rruga Kukës – Krumë, loti 2 (shtesë punimesh);
- Ndërtim i Rrugës së Arbërit (segmenti Ura e Brarit - Hyrje tuneli Qafë-Murrizë), loti 1 (shtesë punimesh));
- Sistemim-asfaltim, rruga Qafë-Thanë - Lin - Pogradec, loti 2 (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, rikonstruksioni dhe zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, segmenti F. F-Unaza Tiranë (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan (shtesë punimesh));
- Supervizion punimesh, sistemim-asfaltim rruga Kukës – Krumë, loti 2 (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, ndërtim i Rrugës së Arbërit (segmenti Ura e Brarit - Hyrje tuneli Qafë-Murrizë), loti 1 (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, sistemim-asfaltim rruga Qafë-Thanë - Lin - Pogradec, loti 2 (shtesë punimesh).

2. Ngarkohen Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 756, datë 5.9.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “NDËRTIM K/RRUGA NACIONALE LAÇ - PATOK (VAZHDIMI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim K/rruga nacionale Laç - Patok (vazhdimi)”, të llojit arë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen arë prej 12 085 (dymbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e pesë) m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 3 359 630 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 265 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 359 630 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2013, zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar për këtë vit.

6. Shpronësimi të fillojë nga data 15.9.2013.

7. Pronarët e pasurive, të përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve në bazë të pikës 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin, të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE
SEGMENTI RRUGOR "Ndërtim K/Rruga Nacionale Laç-Patok"

Qarku:LEZHE

Fshati: Fshati Laç

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	ARE			Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri			Sip. m2	Cmimi m2	Vlera ne leke	
1	Pren	Mark	Syziu	2365	3/9	1689	278	469542	Konfirmuar nga ZRPP
2	Pren	Mark	Syziu	2365	3/9	904	278	251312	Konfirmuar nga ZRPP
3	Gjon	Zef	Luka	2365	3/8	4256	278	1183168	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bardhok	Zef	Prenga	2365	3/13	157	278	43646	Konfirmuar nga ZRPP
5	Dile		Syziu + BP	2365	4/3	3818	278	1061404	Konfirmuar nga ZRPP
6	Dile		Syziu + BP	2365	4/4	1261	278	350558	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				12085		3359630	

VENDIM
Nr. 773, datë 5.9.2013

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Bashkëlidhet lista shtesë e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me numrat rendorë 24/1, 97/1, 97/2, 1019/1, 974/1, 696/1, 958/1 dhe 1193 (një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) – 1219 (një mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë).

b) Në listën bashkëlidhur vendimit, përmasat e pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët bashkëlidhur këtij vendimi.

Lista përbëhet gjithsej nga 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 775, datë 5.9.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KAMËZ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Kamëz të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



Lista e inventarit me 241 (dyqind e dyzetë e një) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi përfundon me numrin rendor 1809 (një mijë e tetëqind e nëntë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Kamëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Bashkia Kamëz

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
12	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore	Në pronësi
20-24	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën kulturore e sportive	Në pronësi
41	Varrezat publike	Në pronësi
42, 72-82, 85-100, 756-940	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
83, 84, 101-742	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
941-951	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
43-52, 55, 62-71, 743, 744, 751, 755, 1447-1634 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM

Nr. 781, datë 5.9.2013

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Neritan Alibali, Zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr. 782, datë 5.9.2013

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Enno Bozdo, Zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 783, datë 5.9.2013

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Brikena Kasmi, Zëvendësministër i Drejtësisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 784, datë 5.9.2013

PËR LIRIM NGA DETYRA

